

I-Project
“Stop Pengeseva”

Qëllimi

Projekti “Stop Pengeseva” është ideuar në formën e një hapësire dixhitale drejtuar qytetarëve me qëllim identifikimin e atyre hallkave të panevojshme të procedurave administrative me të cilat janë përballur kaq vite.

Fokusi kryesor i këtij projekti online qëndronte në mbledhjen e propozimeve për eliminimin e këtyre procedurave apo zëvendësimin me procedura më inovative, të cilat do të ulnin kostot shtesë të sipërmarrjes dhe rrisnin konkurrueshmërinë.

Kohëzgjatja

23 shtator 2017-23 nëntor 2017

Fokusi

Në kuadër të bashkëqeverisjes, në fokus group të këtij projekti qenë rreth 150.000 sipërmarrje të vogla, si një mënyrë e drejtpërdrejtë për të marrë në konsideratë propozimet për lehtësimin e procedurave të gjata që ata hasin gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre në raport me shtetin. Gjithashtu pjesë e këtij në fokusi qenë dhe studentë të cilët mund të marrin pjesë e të konkurojnë përmes propozimeve më të thelluara në argumenta ligjore për këtë project ku më të mirët do të kenë mundësinë e intership-it pranë zyrës së Ministres së shtetit për mbrojtjen e sipërmarrjes.

Rezultati

Rezultatet e përftuara nga Projekti “Stop Pengeseva” u integruan si pjesë e paketës së propozimeve drejtuar Qeverisë nga Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes dhe të lançuara më datë 27 dhjetor në takimin e zhvilluara nga Ministria me 70 sipërmarrës. Raporti i Propozimeve gjendet i botuar në faqen zyrtare të Ministrisë në seksionin “Publikime”.